



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.12.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

- Miratimi i procesverbalit të datës 15 nëntor 2019.
- Diskutimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11367, datë 25.11.2019, “Për kthimin e ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë””.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Ramazan Gjuzi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Lindita Nikolla, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Mirela Kumbaro, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Klajdi Qama, Erion Piciri.

Mungojnë:

Enada Kapllani, Ambra Barova.

Të ftuar:

Bledar Dervishaj – këshilltar i Presidentit të Republikës,
Voltisa Koçi (Bleta) - specialiste në Sektorin e Këshillimit Ligjor dhe Monitorimit të Impaktit të Akteve Rregullatore në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
Iva Beliu – specialiste në Sektorin e Standardizimit dhe Eficiencës Administrative në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

HAPET MBLEDHJA

Fatjona Dhimitri – Përsëendetje!

Para se të vijoj me rendin e ditës, a ka ndonjë kundërshtim apo ndonjë sqarim për procesverbalin e datës 15 nëntor 2019?

Miratohet procesverbali.

Vijojmë me rendin e ditës.

Sot do të kemi diskutimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11367, datë 25.11.2019, “Për kthimin e ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë””.

I ftuar nga Presidenca është zoti Bledar Dervishaj, këshilltar. Të ftuar nga MASR-ja janë zonja Voltisa Koçi, specialiste në Sektorin e Këshillimit Ligjor dhe Monitorimit të Impaktit të Akteve Rregullatore dhe zonja Iva Beliu, specialiste në Sektorin e Standardizimit dhe Eficiencës Administrative.

Vijojmë me shqyrtimin e dekretit të Presidentit.

Fjala është për zotin Bledar Dervishaj.

Zoti Dervishaj, lidhur me arsyet e kthimit të ligjit në Kuvend, si mendoni ju, a e shkel ligji Kushtetutën? A sjell një përfaqësim të njëanshëm të të rinjve?

Bledar Dervishaj – Duhet t’u përgjigjem pyetjeve apo të bëj një përmbledhje të arsyeve?

Fatjona Dhimitri – Vijojmë me arsyet e kthimit të ligjit dhe, më pas, nëse kemi cenim të Kushtetutës apo përfaqësim të njëanshëm të interesave të të rinjve sipas këtij ligji.

Bledar Dervishaj – Faktikisht, roli i Presidentit të Republikës duhet kuptuar më thellë, sepse nuk është vetëm të shikojë vlerësimin e përputhshmërisë së një ligji me Kushtetutën. Ai përfaqëson një interes më të gjerë publik, është pjesë e procesit legjislativ dhe kthimi i ligjit për rishqyrtim në Kuvend, është një e drejtë që Kushtetuta ia ka dhënë, me qëllim tërheqjen e vëmendjes Kuvendit për disa aspekte që Presidenti i Republikës i vlerëson të nevojshme, që duhen parë në një këndvështrim më të thelluar.

Unë nuk do të ndalem të lexoj 9 faqe arsyetim, kjo edhe për ekonominë e kohës së komisionit, por në mënyrë të përmbledhur po lexoj arsyet më kryesore të kthimit të këtij ligji.

Pas administrimit të ligjit në institucionin e Presidentit të Republikës, në shqyrtimin e tij Presidenti ka ndjekur me vëmendje dhe ka vlerësuar të gjitha qëndrimet publike dhe shqetësimet e ngritura, të përcjella dhe të bëra publike nga organizata jofitimprurëse, aktorë me zë, të cilët kanë ndjekur procesin e konsultimit të këtij ligji apo kanë dhënë mendimin e tyre gjatë fazës së shqyrtimit apo pas miratimit të tij.

Presidenti, në vlerësim të të gjitha problematikave të rinisë shqiptare sot, krahasuar me mundësitë që ky ligj ofron, ka vlerësuar se ligji i objektit të shqyrtimit nuk u përgjigjet nevojave

të zhvillimit dhe pritshmërive të rinisë shqiptare dhe nuk garanton përmirësimin e situatës së rinisë, siç relatohet qeveria në propozimin e kësaj nisme.

Në përfundim, Presidenti ka vlerësuar se ky ligj bie në kundërshtim me parimet kushtetuese, si dhe fryma e tij nuk përputhet me interesat reale të të rinjve shqiptarë. Për rrjedhojë, ky ligj nuk është në harmoni as me interesin publik, as me interesin kombëtar.

Për këto arsye Presidenti, me dekretin nr.11367, datë 25 nëntor, ka vendosur kthimin e ligjit për rishqyrtim, me qëllim rishikimin e disa çështjeve që janë arsyetuar bashkëlidhur dekretit.

Presidenti, në vlerësim të të gjitha problematikave të rinisë shqiptare sot, krahasuar me mundësitë që ligji ofron, vlerëson se ky ligj nuk përputhet me nevojat e zhvillimit dhe pritshmërive të rinisë shqiptare dhe nuk garanton mirëqenien e tyre. Ligji jo vetëm që nuk sjell rregullimin e dëshiruar dhe të pritshëm, por për disa çështje thelbësore, bie ndesh me parimet dhe normat kushtetuese.

Ligji i miratuar evidenton se do të trajtojë të rinjtë shqiptarë në diasporë, por nuk qartëson aspak në mënyrë reale dhe të vërtetë se si kjo normë e re ligjore do të ndihmojë këtë pjesë të rinisë shqiptare që ndodhet jashtë atdheut.

Konstatohet se është e domosdoshme kryerja e një studimi objektiv dhe shumëplanësh para miratimit të një ligji të plotë për rininë. Ky proces është shumë i nevojshëm, pasi në të kundërt do të krijohet një normë e re ligjore vetëm formale, por nuk do të garantojë aplikimin me sukses i saj në praktikë.

Pra, në ndërmarrjen e kësaj nisme mungon identifikimi real dhe trajtimi thelbësor i vërtetë i problematikave që ka sot rinia shqiptare, të tilla si: mospërshtatja e sistemit arsimor me tregun e punës; mungesa e vizionit të qartë për jetën; mungesa e informacionit rreth tregut të punës; mungesa e argëtimit; papunësia; paragjykimin dhe diskriminimin ndërmjet të rinjve; mospjesëmarrja në proceset dhe vendimmarrjet politike apo çështje të tjera sociale të hasura në praktikë dhe në realitetin e sotëm shqiptar.

Në disa dispozita ky ligj tenton të vendosë në kontroll politik organizimin rinor, gjë e cila do të përbënte cenim të rëndë të të drejtës së çdo të riu për t'u shprehur dhe për t'u organizuar lirisht. Cenimi i të drejtës së çdo të riu për të zgjedhur përfaqësuesit e tij në mënyrë të lirë dhe jashtë ndikimit politik, do të përbënte në themel një cenim të demokracisë.

Nenet 9 dhe 10 të ligjit bien ndesh me parimet kushtetuese dhe krijojnë mundësinë e një varësie politike të drejtpërdrejtë të organizatave rinore, çka rrjedhimisht do të përbënte shtrembërim të vullnetit të të rinjve shqiptarë. Funkionarëve politikë të nivelit qendror apo vendor, përkatësisht ministri dhe kryetari i bashkisë, sipas përcaktimeve të nenit 9 dhe 10 të

ligjit, u jepet për kompetencë të udhëheqin strukturat e reja të organizimit të të rinjve, që janë Këshilli Rinor Kombëtar dhe Këshilli Vendor i Rinisë.

Duke vlerësuar këtë varësi të drejtpërdrejtë, si dhe kompetencën e ministrit dhe të kryetarëve të bashkive për miratimin e anëtarëve të këshillave përkatës, përfaqësimi i organizatave rinore rrezikohet të orientohet drejt përparësive afatshkurtra të çastit, të ndara dhe jogjithëpërfshirëse, duke qenë pre e një politizimi të theksuar të pushtetit qendror.

Kjo mënyrë organizimi dhe përfaqësimi e vullnetit rinor duket se tenton vendosjen nën kontrollin politik të të gjithë organizimit të jetës rinore në vend, që do të ishte rezultati më i rëndë i shkeljes së të drejtave dhe lirisë së shprehjes të pjesës më jetësore të shoqërisë, që është rinia, si dhe një cenim të demokracisë në vendin tonë dhe rrjedhimisht të parimeve kushtetuese.

Ndërkohë, si për ta rënduar këtë situatë, neni 9, pika 2, dhe neni 10, pika 2, përmbajnë një parashikim të paqartë të balancës dhe nivelit të pjesëmarrjes së organizatave rinore ose të rinjve si në Këshillin Kombëtar Rinor, ashtu edhe në Këshillin Vendor të Rinisë.

Procesi i emërimit politik në Këshillin Kombëtar Rinor, në Këshillin Vendor të Rinisë, si dhe niveli i paqartë i përfaqësimit të rinisë në këta organizma, që mbetet sërish në lirinë e veprimit dhe vullnetit të një funksionari politik, e vendos realisht nën kontroll dhe nën mbikëqyrje rininë shqiptare dhe krijon rrezikun që çdo përfaqësues me zë objektivisht opozitar me vullnetin politik, që qeveris në nivel vendor apo vendor, të ngelet jashtë këtyre organizmave apo zëri i tij të mos merret parasysh.

Ministri dhe kryetarët e bashkive, nëpërmjet anëtarësimit të zgjedhur prej tyre, do të drejtojnë në mënyrë përcaktuese hartimin e politikave rinore dhe administrimin e të gjithë procesit deri në financimin e tij. Kjo nuk i shërben as mirëfunksionimit të shtetit të së drejtës dhe as përfaqësimit gjithëpërfshirës të grupeve të ndryshme rinore.

Parashikimet e ligjit përpiqen të krijojnë idenë fiktive se shteti po përmbush objektivat e tij sociale përkundrejt rinisë shqiptare, të parashikuara në nenin 59 të Kushtetutës, ndërkohë që ligji i miratuar nuk përshtatet as me frymën, as me preambulën e Kartës Sociale Europiane dhe as me parashikimin e nenit 7 të saj, që garanton të drejtën e rinisë për mbrojtje, për siguri juridike, ekonomike apo sociale.

Në asnjë paragraf të ligjit nuk thuhet se cilët do të jenë mekanizmat për të nxitur nismat, që do të ndihmonin në nxitjen e vetëpunësimit apo punësimit të të rinjve që vijnë nga shtresat e lëna mënjanë dhe ato në nevojë.

Nisur nga situata e krijuar, ku të rinjtë shqiptarë po ikin gjithnjë e më shumë me dëshirë për të ndërtuar jetën jashtë vendit, ky ligj duhet patjetër të ofronte garanci dhe mundësi reale,

shpresë, si dhe të dekurajonte emigrimin e tyre jashtë vendit. Për fat të keq, ky ligj nuk i garanton këto.

Ligji nr. 75/2019 në disa dispozita është i paqartë dhe për pasojë, cenon sigurinë juridike dhe e bën krejtësisht të pasigurt realizimin e qëllimit për të cilin u ndërmor kjo normë.

Ligji nuk krijon as orientimin e duhur, nuk jep kompetencat e nevojshme, krijon varësi të drejtpërdrejtë politike dhe cenon parimin e sigurisë juridike, në shkelje të Kushtetutës dhe të parimeve të së drejtës të të rinjve shqiptarë për mbrojtje ekonomike, ligjore e sociale, të parashikuara në Kartën Sociale Europiane.

Për gjithë sa u parashtrua më sipër, me qëllimin e vetëm hartimin e një norme ligjore në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe aktet ndërkombëtare, në bindje të Kushtetutës dhe bazuar në nenin 85, pika 1, Presidenti i Republikës, me dekretin që ju cituat, ka vendosur kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 75/2019 “Për rininë”, në mënyrë që ky ligj të përmirësohet jo vetëm në nenet 9 e 10 të tij, por edhe në tërësi.

Në mënyrë që Kuvendi të miratojë një ligj do të duhet të adresojë drejt, objektivisht dhe me zgjidhje konkrete gjithë gamën e problemeve dhe shqetësimeve me të cilat përballen sot të rinjtë shqiptarë.

Faleminderit!

Në mënyrë të përmbledhur ky ishte arsyetimi. Arsyetimi është më i gjatë dhe deputetët e kanë në administrim.

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

Nga MASR-ja të bëhen komentet lidhur me arsyet e kthimit të ligjit.

Voltisa Koçi – Ju faleminderit!

Edhe ne jemi njohur me dekretin e Presidentit të Republikës, të shpallur në datën 25 nëntor të vitit 2019.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e cila ka në fushën e përgjegjësisë shtetërore edhe çështjen e të rinjve shqiptarë, e ka hartuar projektligjin “Për rininë” me qëllimin e vetëm për përcaktimin e veprimtarive të mekanizmave dhe autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve dhe duke u mbështetur fuqimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në aktet ndërkombëtare të ratifikuara dhe kudo tjetër, me qëllimin e vetëm për të parashikuar një mbrojtje të veçantë për të rinjtë shqiptarë dhe për t’u krijuar mundësi për të realizuar qëllimet e organizimit të tyre, të mbështetjes reale dhe konkrete, që ky ligj e propozon dhe e ka realizuar më së miri edhe me procedurat përkatëse që parashikon në përmbajtjen e tij, me qëllim që të rinjtë shqiptarë të përfaqësohen sa më mirë e sa më denjësisht në shoqërinë shqiptare, duke respektuar gjithmonë të drejtat e tyre, mosdiskriminimin,

barazinë, garantimin e pjesëmarrjes së këtyre të rinjve në procese të ndryshme politikëbërëse apo vendimmarrëse në fushën e arsimit, kërkimit shkencor e më gjerë, sigurisht, edhe në politikat financiare, në mundësinë e punësimit të tyre, pjesëmarrjen vullnetare dhe elemente të tjera që lidhen me këtë.

Në këtë kuadër, Ministria e Arsimit u qëndron plotësisht të gjitha neneve që janë në përmbajtje të projektligjit “Për rininë”, gjithsej 20 nene, duke mos pranuar ndryshimin, pakësimin apo zgjerimin e mëtejshëm të tij.

Ne e propozojmë këtë projektligj, duke menduar që është mënyra më e mirë për të përfaqësuar rininë shqiptare sot, për të realizuar qëllimet e saj në vetvete dhe çdo gjë tjetër që lidhet me këtë kontingjet.

Në mënyrë të përmbledhur, për ekonominë e kohës së këtij komisioni, mendojmë se do t’i qëndrojmë propozimit të bërë nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për këtë projektligj.

Ju faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Ju mendoni se vendosja e Këshillit Kombëtar të Rinisë në varësi të ministrit përgjegjës apo vendosja e Këshillit Vendor të Rinisë në varësi të kryetarit të bashkisë është e drejtë? Pra, krijon një përfaqësim të barabartë të interesit të të rinjve për sa u përket organizatave rinore?

Voltisa Koçi - Në lidhje me këtë, siç parashikohet në nenet përkatëse 9 dhe 10 të projektligjit “Për rininë”, është propozuar ngritja e një këshilli kombëtar për rininë.

Ky projektligj krijon vetëm bazën e nevojshme ligjore për të rinjtë, me qëllim që ata të kenë një pjesëmarrje sa më integruese për përfaqësimin e plotë të tyre, për dhënien e mendimit të tyre për problematikat që ata hasin në përditshmërinë e tyre. Kjo bëhet me qëllim që të dëgjohet zëri i tyre, por kjo strukturë përbën vetëm një strukturë konsultative, e cila do të jepte thjesht mundësinë që këta të rinj të operojnë dhe të paraqesin ato që vlerësojnë në jetën e përditshme, problematikat me të cilat hasen. Kjo do ta ndihmonte më shumë Ministrinë e Arsimit, e cila, siç e thamë, ka në fushën e saj të përgjegjësisë shtetërore çështjet e rinisë, që të marrë nga zëri i të rinjve problematika që ato përcjellin, vetëm si një organ konsultativ, në mënyrë që të tejçohen problemet e vërteta dhe krijimi i një baze ligjore më të plotë.

Sigurisht që ky projektligj do të ketë edhe aktet e veta nënligjore, që në mënyrë praktike do të përcjellin më së miri edhe çështjet konkrete procedurale se si do të realizohen ato, por gjithsesi këta këshilla kanë vetëm karakter konsultativ. Kjo besoj se duhet theksuar.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Pra, ju mendoni se në kushtet aktuale, kur edhe pushtetit lokal, edhe pushteti qendror, janë shprehje e vullnetit politik të njëres palë, kjo nuk përbën problem dhe nuk i cenon aspak interesat e të rinjve?

Voltisa Koçi – Tek të rinjtë nuk kanë rëndësi farë çështjet politike. Ne i japim përparësi arsimit, rinisë, sportit dhe gjithçkaje që përfshihet në fushën tonë të përgjegjësisë.

Fatjona Dhimitri - Në cilat nene e shihni ju integrimin e të rinjve? Pra, si e shihni pozitivitetin, kushtet favorizuese që krijohen, qoftë për punësimin e të rinjve në këtë ligj, qoftë për shmangien e emigrimit masiv të të rinjve? Ju e dini që shumë të rinj shqiptarë kërkojnë të largohen për arsye pune nga vendi i tyre.

Voltisa Koçi – Që në objektin e këtij projektligji, ashtu edhe në qëllimin e tij, siç e përmendëm edhe më parë, parashikohet përcaktimi i veprimtarive dhe mekanizmat e autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve, duke përfshirë edhe të rinjtë shqiptarë në diasporë, që u përcoll nga pala, si dhe mundësia e financimit të veprimtarive të tyre në kuadër të të drejtave të të rinjve për të realizuar një mbrojtje të veçantë të tyre nga shteti. Në qëllimin e projektligjit dhe në gjithë përmbajtjen e tij parashikohet më së miri çështja e mbrojtjes së të rinjve, që do të udhëhiqen gjithmonë nga parimet e frymës kushtetuese për barazi, mosdiskriminim dhe elemente të tjera që flasin për këto parime.

Fatjona Dhimitri – Pra, ju mendoni se mekanizmat institucionalë, të cilët do të mbikëqyrin krejt procesin e mbarëvajtjes së ligjit “Për rininë”, janë favorizues?

Si mendoni ju, a respektohet parimi *check and balance* këtu?

Voltisa Koçi – Sigurisht që do të respektohet. Ky është qëllimi.

Fatjona Dhimitri – A ka pyetje nga anëtarët e tjerë të komisionit?

E hedhim në votim dekretin e Presidentit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vetëm pak, të lutem! Urdhëro!

Kostaq Papa – Përsëndetje!

Pa dashur të bëhem palë, sepse e mendojmë Presidentin mbi palët, desha të prek pak problemin se si e trajton ligji rininë e diasporës. Thuhet diku se për diasporën do të ndikojë te organizimi, por, në fakt, më poshtë nuk shpreh asgjë. Si e arsyetoni ju këtë problem?

Faleminderit!

Voltisa Koçi – Ju faleminderit për pyetjen!

Siç e përmendëm edhe pak më parë, që te qëllimi i projektligjit, ashtu siç thoni edhe ju, çështja që ka të bëjë me mundësinë e zhvillimit të veprimtarisë së mekanizmave të autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen e të rinjve, edhe për të rinjtë shqiptarë në diasporë është e caktuar.

Kjo është përcaktuar jo vetëm në qëllimin e këtij projektligji, por zgjerohet më tej edhe në nenin 7 të projektligjit, në pikën 4 të tij, ku ndër të tjera parashikohet se njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë me organizatat për të rinjtë dhe organizatat rinore shqiptare në diasporë për të mbajtur një komunikim me të rinjtë shqiptarë që janë larguar nga vendi për arsye studimesh ose të tjera, me qëllim angazhimin dhe aktivizimin konkret të tyre në zhvillimet që ndodhin në Republikën e Shqipërisë.

Siç e thashë edhe pak më parë, do të ketë edhe akte nënligjore, të cilat do të zbërthejnë më tej çështjet e këtij ligji nga pikëpamja materiale dhe procedurale për mënyrën se si do të realizohet edhe më mirë sigurimi i pjesëmarrjes së të rinjve shqiptarë nga diaspora, me qëllim aktivizimin e tyre në veprimtaritë konkrete që ndodhin në Republikën e Shqipërisë dhe dëgjimi i mendimit të tyre. Ndër të tjera, qëllimi i këtij projektligji është edhe pjesëmarrja e të rinjve shqiptarë në diasporë.

Fatjona Dhimitri – Ka pyetje të tjera?

Almira Xhembulla – Duke qenë se kam qenë relatore e projektligjit, kjo që do të them është më shumë koment sesa pyetje.

E para, dua të falenderoj përfaqësuesit e ministrisë për komentet shteruese për sa i përket mendimit tonë dhe të tyre për dekretin e Presidentit. Dua të theksoj faktin që vlerësohet, që merret në konsideratë një analizë e detajuar, qoftë nga pikëpamja e teknikës legjislative, qoftë edhe ashtu siç u përmend nga përfaqësuesi i Presidencës, ndoshta duke e parë më gjerë interesin e qytetarëve. Për vetë rëndësinë që ne si komision përgjegjës i kushtuam këtij projektligji dhe kohën e duhur që lamë në dispozicion, qoftë për të përfshirë komentet e të gjitha grupeve të interesit, qoftë edhe punën e grupit të Komisionit të Ligjeve, me qëllim për ta rishikuar në detaje nga aspektet e teknikës legjislative, mendoj që kemi bërë një punë shteruese dhe jashtëzakonisht të mirë për sa i përket reflektimit të këtyre dy aspekteve.

Ndërkohë, dua të sjell në vëmendje që projektligji, ndryshe nga disa projektligje të tjera, është diskutuar në të 12 qarqet e vendit, ku janë marrë komentet e të gjithë të rinjve në këto qarqe. Ka qenë një projektligj tejet gjithëpërfshirës, për të cilin janë bërë diskutime.

Në varësi të merakut që ju keni për parimin *check and balance*, dua të them që për një kohë të gjatë organizatat e shoqërisë civile e kanë pasur të vështirë të jenë pjesë e forumeve apo grupeve që përfaqësojnë direkt në bashkëpunim me qeverisjen lokale apo qeverisjen kombëtare. Në një farë mënyre, kjo do të institucionalizojë përfshirjen e organizatave rinore në diskutime, qoftë në nivel lokal, qoftë edhe në nivel kombëtar. Kështu që, për sa i takon pjesës së të qenurit gjithëpërfshirës, të marrjes në konsideratë të mendimeve të tyre, por ndoshta edhe pikëpamjeve të drejta, në detaje, të parë nga këndvështrimi i teknikës legjislative, unë mendoj

që ne do t'i qëndrojmë votimit që kemi bërë si komision përgjegjës, por edhe vendimit të seancës plenare.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Pra, ju po thoni që nuk kërkon të merrni kohën e nevojshme për të shqyrtuar edhe një herë dekretin e Presidentit, për t'iu përmbajtur edhe një herë përmbajtjes së tij.

Almira Xhembulla - ... të cilit ne i kemi dhënë kohë ndoshta pak më shumë sesa projektligjeve të tjera.

Fatjona Dhimitri – Fakti që, sipas jush, organizatat rinore vendosen në diktatin e ministrisë përkatëse për ju nuk përbën aspak problem?

Almira Xhembulla – Gjithsesi, ne do të diskutojmë përsëri tani në komision. Parimisht është projektligji të cilit ne i kemi dhënë kohën e mjaftueshme dhe të duhur për të marrë në konsideratë komentet e grupeve të interesit, por edhe për ta parë në detaje nga ana e teknikës legislative.

Fatjona Dhimitri – Pra, krijimi i një përfaqësie të njëanshme të organizatave rinore, sipas vullnetit politik, sipas forcës politike, përsëri nuk përbën një problem për ju? Ligji sjell një përfaqësim të pabarabartë të të rinjve, pavarësisht fasadave për krijimin e strukturave për punësim. Më tej akoma, Shërbimit Kombëtar të Punësimit i hiqen kompetencat e tij dhe nuk i jepet zgjidhje çështjes së kartës së studentit.

Almira Xhembulla – Për çështjen e punësimit ne kemi një ligj për nxitjen e punësimit të të rinjve, ku janë të parashikuara të gjitha politikat që lidhen me nxitjen e punësimit.

Fatjona Dhimitri – Atëherë pse është i nevojshëm krijimi i mekanizmave shtesë jofunksionalë?

Almira Xhembulla – Ndërkohë, këto janë mekanizma që nxisin vullnetarizmin dhe përfshirjen e tyre në edukimin gjatë gjithë jetës dhe të të bërit të tyre kompetentë, ashtu si çdo bashkëmoshatar i tyre në vendet e Bashkimit European.

Fatjona Dhimitri – Përpara se ta hedhim në votim dekretin, dëshironi të merrni edhe një herë kohën e nevojshme për ta shqyrtuar atë dhe për t'iu përmbajtur edhe një herë praktikave?

Po, urdhëroni!

Ismet Beqiraj – Në thelb, i gjithë kontestimi i shprehur edhe me dekretin e Presidentit janë nenet 9 dhe 10. Për opinionin publik, por edhe për të rinjtë, Presidenti shprehet që këto nene bien ndesh me parimet kushtetuese dhe krijojnë mundësinë e një varësie politike të drejtpërdrejtë të organizatave rinore.

Unë nuk kam pse të bëj pyetje për këtë, sepse sqarimet i bëri përfaqësuesja e Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, por edhe relatorja. Pse i përkthejmë këto dy nene në interesa politike të çastit, që kërkojnë edhe ata, të gjithë në politikë bëjmë këtu, që janë në këtë tavolinë, përfshirë deri te piramida e lartë e shtetit? Në pikën 1 të nenit 9 dhe në pikën 1 të nenit 10 thuhet që Këshilli Kombëtar i Rinisë dhe Këshilli Vendor i Rinisë është organ këshillimor, konsultativ, që çdo institucion i shtetit e ngre për të mbrojtur interesat e rinisë, në rastin konkret dhe nuk është organ politik. Nuk emëron, nuk shkarkon dhe nuk vendos. Këtë organizëm që shpreh dhe bie frymën e kërkesave të të gjithë të rinjve pa dallim bindjeje politike, brenda dhe jashtë vendit, ne e kthejmë me zor në një organ politik. Është organ këshillimor, që vetëm këshillon dhe kjo është e drejta ekskluzive e çdo organi në një superstrukturë të shtetit. Është një risi që në Shqipëri në këto 30 vjet rinia bëhet me një ligj.

Fatjona Dhimitri – Sa funksional do të jetë ky ligj?

Ismet Beqiraj – Ju lutem, mos më ndërhyjni!

Ligjet nuk janë të shkruara në gurë. Gjatë implementimit të tij, korrigjohet dhe vërtetohet. Pse duam ne t'i kthejmë me pahir në një organizëm politik? Jo, është organizëm këshillimor, konsultativ, asgjë më tepër nuk bën.

Fatjona Dhimitri – Të përzgjidhen sipas përkatësisë partiake? Si mendoni ju?

Ismet Beqiraj – Ju lutem, nuk do t'i bëjmë pyetje njëri-tjetrit, sepse nuk është as në etikën e Kodit!

Ky është mendimi im si deputet. Kjo bëhet për *show* politik. Ne do të shesim politikë, por jo qëllimkeq. Është një organizëm këshillimor dhe është domosdoshmëri.

Fatjona Dhimitri – Urdhëro, Erion!

Erion Piciri – Unë mendoj që ligji është i panevojshëm, sepse ajo çfarë kërkon sot rinia shqiptare është cilësia e universiteteve dhe e shkollave.

Para një viti e gjysmë unë kam pasur rastin të jap disa trajnime te forumet që dukeshin sikur ishin rini e përgjithshme, por në fakt ishin rini partiake. Problemi më i madh i shoqërisë shqiptare është tërheqja e rinisë drejt këtyre çetave politike. Ka filluar që në vitin 1944 dhe vazhdon ende sot e kësaj dite. Ajo që kërkon rinia shqiptare dhe më të mirët prej tyre që ikin, kanë ikur rreth 30 mijë, është cilësia e arsimit shqiptar, që e kemi nga më të dobët në Ballkan dhe në Europë. Të gjitha përgjigjet janë te buxheti i shtetit, buxheti për arsimin, kurse të tjerat janë lojëra. Do të sponsorizojnë një pjesë të rinisë që ata duan, por nuk zgjidhin problemin e madh të rinisë shqiptare, që sot po ikën, më e mira, rreth 30 mijë, nga të cilët, në këto 10 vjet, 94% e tyre, sipas sondazheve, nuk kthehen më në Shqipëri. Po na ikin njerëzit më të mirë.

Sikurse e kam thënë, ne mbarojmë shkollën e mesme dhe kemi diplomë 8- vjeçareje; krahasuar me vendet më të mira të kësaj bote, universitetet i kemi nga më të dobëtit. Ky është thelbi. Afrimi i rinisë në çeta partiake u shërben fushatave elektorale dhe politikës, por jo asaj që ne duhet të kemi, një rini kërkimore, të inovacionit, me mendje të hapur, që i flet botës. Ky është thelbi. Mendoj se ligji është pa sens. Është teori që nga viti 1944, kur ata që e morën pushtetin e morën me disa kalamaj dhe vazhdoi, duke menduar se ndoshta me fëmijët do të arrijnë ... Thelbi i të gjithë asaj që diskutojmë në këtë lloj vendi është që rinia të shkojë drejt shkollës, por shkollës cilësore, që ne nuk e kemi. Ligje mund të vijnë sa të duan, janë një lloj centralizimi, u japin lekë disa shoqatave rinore, por nuk zgjidhin thelbin e problemit.

Një nga elementet bazike të politikës është diagnostikimi korrekt i asaj se çfarë po ndodh sot në Shqipëri: braktisja e më të mirëve, shkolla jo cilësore. Këtë e thonë të gjitha raportet ndërkombëtare. Ky është thelbi, kurse për të tjerat, mund të diskutojmë pa fund. Mund t'i kthejmë ligjet nga të gjitha drejtimet. Rinia kërkon shkolla cilësore, kurse shkollat cilësore duan para. Të investojmë më shumë nga buxheti i shtetit. Teoria ime është 6,5 % e GDP-së: 4,5% në shkolla dhe 2% për kërkimin. Ky është ndryshimi i madh. T'i heqim këto para nga rrugët e askundit. Janë disa rrugë që na çojnë drejt Peshkopisë me 25 mijë banorë dhe lëmë 800 mijë qytetarë shqiptarë, nxënës dhe studentë në

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dibra ka 25 mijë qytetarë, me gjithë respektin, por edhe ata duan arsim cilësor për fëmijët e tyre. Në rrugën e askundit ne investojmë 1 miliard euro. Ndoshta prandaj jemi këtu. Nëse unë do të isha ministër Arsimit apo Kryeministër i vendit, paratë që shkojnë dëm do t'i çoja drejt rinisë. Rinia do shkolla cilësore dhe jo bashkime në çeta partiake. Ne japim shembullin më të keq. E afrojmë rininë drejt politikës, në momentin që rinia në moshën 15-25 vjeç ka nevojë për dije, kërkimin shkencor dhe të krahasohet me të ngjashmit e vet në mbarë botën. Ky është kombi që ne duhet të ndërtojmë. Kombi i partisë ka vdekur. Do ta merrni vesh në disa vite. Vdiq partia. Është momenti i sipërmarrjes, i shkollës, i arsimit, i teknologjisë dhe inovacionit, i kombeve që konkurrojnë përmes mendjeve brilante, që investojnë siç duhet.

Faleminderit!

Almira Xhembulla – Për procedurë.

Fatjona Dhimitri – Po, urdhëro!

Almira Xhembulla - E vlerësoj shumë faktin që profesori, duke pasur parasysh që ka një *background* të tillë, i mëshon më shumë cilësisë së arsimit, por ndihem jashtëzakonisht keq që thotë këtu diçka që lidhet me një investim shumë strategjik për një nga zonat më të rëndësishme, një nga qarqet më të rëndësishme, si Dibra. Më falni profesor, por edhe shifrën

për numrin e popullsisë e keni tërësisht të gabuar, sepse shifra që thatë ju është vetëm për një qytet, ndërkohë që atje kemi katër bashki të tjera. Është një qark me rreth 80 mijë banorë dhe një nga zonat me potenciale turistike, bujqësore, vlerash, që kanë ditur të tregojnë dhe, pa diskutim, janë një vlerë e shtuar e shtetit shqiptar.

Ndërkohë, bëhet fjalë edhe për një popullsi tjetër, që lidhet me Dibrën matanë kufirit dhe të gjitha trojet e shqiptarëve në zonën e Maqedonisë. Ju kërkoj ta tërhiqni atë që thatë, në respekt të të gjithë qytetarëve dibranë.

Unë i jam shumë falënderuese qeverisë që më në fund ka vendosur, me një mekanizëm që e cilësoj shumë të drejtë, të mbështesë një nga investimet strategjike më të mëdha në infrastrukturë që ka qeveria shqiptare! Uroj dhe jam e bindur që gjithçka do të shkojë ashtu siç është parashikuar! Shpresoj shumë që e gjithë zona e Dibrës, me vlerat që ka, me sakrificat e mëdha që i është dashur të bëj si një xhep i Shqipërisë në të gjitha këto vite, të integrohet në Shqipëri, sepse është një nga zonat më të izoluara për momentin. Është katër orë e gjysme prej këtu. Nuk mund të lejoj që të jesh në krahun tim dhe të thuash që është një investim që nuk duhet të bëhet!

Erion Piciri – Kam vetëm dy fjali.

Fatjona Dhimitri – Do të flasim për dekretin e Presidentit për ligjin “Për Rininë” apo do të bëjmë bilancin e dështimeve të qeverisë nga një qytet në tjetrin?

Hedhim në votim dekretin e Presidentit.

Kush është pro dekretit të Presidentit? Kundër? Siç është bërë model dhe trend jo vetëm në komisionin tonë, por në çdo komision parlamentar dhe në Kuvendin e Shqipërisë, çdo akt i Presidentit arrin të rrëzohet. Modeli më i keq që ka ky parlament është ai i shfuqizimit të vendimeve të Presidentit.

Mbledhja për sot mbyllet këtu.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA